

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 22, dhe në lidhje me nënparagrafin 8 nga neni i njëjtë i Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20, 77/21, 154/23 dhe 55/24) dhe neni 3 paragrafët (3) dhe (4) nga Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.154/23), dhe në pajtim me Konkluzionin, nr.02-2978/7 datë 10.07.2024, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 28-të mbajtur më 10.07.2024 miratoi:

Vendim
për pushimin e vlefshmërisë së Udhëzimit për mënyrën e matjes së shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë të programeve, gjegjësisht shërbimeve programore të transmetuesve në Republikën e Maqedonisë

Neni 1

Me këtë Vendim pushon së qeni i vlefshëm Udhëzimi për mënyrën e matjes së shikueshmërisë dhe dëgjueshmërisë të programeve, gjegjësisht shërbimeve programore të transmetuesve në Republikën e Maqedonisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.198/14 dhe 219/15).

Neni 2

Udhëzimi nga neni 1 i këtij Vendimi, nuk prodhon pasoja juridike nga dita e hyrjes në fuqi të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.154/23).

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit, dhe do të botohet në „Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“ dhe në ueb-faqen e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele.

Nr.01-3026/1
11.07.2024
Shkup

Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI d.v